REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

Tiranë më 02.05.2024

Nr. 1172 Prot.

**Lënda:** Dërgojmë dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Faza Strategjike

**MINISTRISË SË FINANCAVE**
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr.3, Tiranë, Albania

Mbështetur në ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" si dhe në zbatim të Udhëzimit nr.7, datë 28.02.2018 "Për proçedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm", Udhëzimit nr.4, datë 28.02.2024 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027" të Ministrisë së Financave si dhe mbështetur në VKM nr.184, datë 27.03.2024 "Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027" bashkëlidhur ju dërgojmë dokumentin e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ku përfshihen kërkesat buxhetore, për fazën strategjike të PBA-së, të cilat janë përgatitur përmes sistemit AFMIS dhe modeleve respektive të përgatitjes së PBA-së, përkatësisht sipas programeve:

- "Planifikim, Menaxhim, Administrim" 01610
- "Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale" 01620

Sa më sipër bashkëlidhur ju dërgojmë raportet e gjeneruara përmes sistemit AFMIS dhe relacionin shpjegues sipas programeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve:

- Formatin e detajimit të fondeve buxhetore për shpenzimet kapitale me financim të brendshëm dhe të huaj 2025-2027
- F.2 - Formatin standart të përgatitjes së kërkesave buxhetore sipas AFMIS 2025-2027 për politikat ekzistuese
- F.3 - Formatin standart të përgatitjes së kërkesave buxhetore sipas AFMIS 2025-2027 për politikat e reja

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**Sekretar i Përgjithshëm**

**Ylli MERKAJ**

Kopje: 2
Afati i ruajtjes: 5 vjet
Punoi:
A.Kota
E.Topulli
A.Lamçe
M. Çelmeta

## KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

## PBA 2025-2027 Faza STRATEGJIKE

**Tabela Nr.1 Kërkesat Shtesë për shpenzime buxhetore 2025 - 2027 KQZ SIPAS PROGRAMEVE**

*ne leke*

| Nr. | Programi "Planifikim, Menaxhim, Administrim" | Artikulli | Kerkesa KQZ | | | TAVANET 25-27 | | | NDRYSHIMET | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Buxheti 2025 | Buxheti 2026 | Buxheti 2027 | Buxheti 2025 | Buxheti 2026 | Buxheti 2027 | Buxheti 2025 | Buxheti 2026 | Buxheti 2027 |
| I | *602 Mallra e Sherbime* | 602 | 192,763,652 | 176,664,359 | 199,638,652 | 44,160,000 | 45,160,000 | 46,160,000 | 148,603,652 | 131,504,359 | 153,478,652 |
| II | *Investime 01 FB* | 231 | 85,369,720 | 62,190,400 | 1,500,000 | 1,500,000 | 1,500,000 | 1,500,000 | 83,869,720 | 60,690,400 | - |
| | ***TOTALI Kerkesa shtese 01610*** | | *278,133,372* | *238,854,759* | *201,138,652* | *45,660,000* | *46,660,000* | *47,660,000* | *232,473,372* | *192,194,759* | *153,478,652* |

*ne leke*

| Nr. | Programi "Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale" | Artikulli | Kerkesa KQZ | | | TAVANET 25-27 | | | NDRYSHIMET | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Buxheti 2025 | Buxheti 2026 | Buxheti 2027 | Buxheti 2025 | Buxheti 2026 | Buxheti 2027 | Buxheti 2025 | Buxheti 2026 | Buxheti 2027 |
| I | *Pagat+Sig 600- personelit te perkohshem ne KQZ-* | 600+601 | 406,808,962 | | 406,808,962 | | | | 406,808,962 | - | 406,808,962 |
| II | *602 Mallra e Sherbime* | 602 | 1,890,000,000 | 16,645,176 | 1,626,647,437 | | | | 1,890,000,000 | 16,645,176 | 1,626,647,437 |
| III | *Investime 01 FB* | 231 | 2,334,488,729 | | | | | | 2,334,488,729 | - | - |
| | ***TOTALI Kerkesa shtese 01620*** | | *4,631,297,690* | *16,645,176* | *2,033,456,399* | | | | *4,631,297,690* | *16,645,176* | *2,033,456,399* |

## Detajim i investimeve te KQZ per PBA 2025-2027 Faza Strategjike 01610

*leke*

| Prog | Llogaria Ekonomike | Kod. D.Thesari | Kod Produkti | Emertimi I produktit | Buxheti 2025 | Buxheti 2026 | Buxheti 2027 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 01610 | 2310000 | 3535 | 18AC301 | Paisje informatike dhe zyre | 1,500,000 | 1,500,000 | 1,500,000 |
| | | | | **Ekzistuese** | **1,500,000** | **1,500,000** | **1,500,000** |
| 01610 | 2310000 | 3535 | *I RI FAZA I* | *Sistemi per indeksimin dhe kerkimin e pamjeve filmike* | 3,000,000 | | |
| 01610 | 2310000 | 3535 | *I RI FAZA I* | *Shtimi i kapaciteteve per ruajten e pamjeve filmike* | 40,000,000 | | |
| 01610 | 2310000 | 3535 | *I RI FAZA I* | *ERP - SOFTWARE per menaxhimin e proceseve, logjistikes, inventar etj* | 34,561,000 | | |
| 01610 | 2310000 | 3535 | *I RI FAZA I* | *Modul per menaxhimin e operatoreve [Menaxhimi i burimeve njerezore part time Moduli part time]* | 4,601,000 | | |
| 01610 | 2310000 | 3535 | *I RI FAZA I* | *Ankimet dhe denoncimet* | 1,707,720 | | |
| 01610 | 2310000 | 3535 | *I RI FAZA I* | *E archiva + arkivë financiare* | | 11,181,500 | |
| 01610 | 2310000 | 3535 | *I RI FAZA I* | *Hartat e Qv dhe facilitete te tjera* | | 19,495,400 | |
| 01610 | 2310000 | 3535 | *I RI FAZA I* | *E administrata* | | 13,321,500 | |
| 01610 | 2310000 | 3535 | *I RI FAZA I* | *Helpdesk/ helpline* | | 16,692,000 | |
| | | | | **Politika te Reja** | **83,869,720** | **60,690,400** | - |
| | | | | **Totali** | **85,369,720** | **62,190,400** | **1,500,000** |

## Detajim i investimeve te KQZ per PBA 2025-2027 Faza Strategjike 01620

| Prog | Llogaria Ekonomike | Kod. D.Thesari | Kod Produkti | Emertimi I produktit | Buxheti 2025 | Buxheti 2026 | Buxheti 2027 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | **TOTAL SHPENZIME KAPITALE 01+02** | **2,346,388,729** | **11,900,000** | **11,900,000** |
| 01620 | 2310000 | 3535 | 22AF801 | *Pajisje Elektronike të Votimit dhe Numerimit* **PEVN** [Blerje pajisje (hardware) për Qendra Votimi] | 2,281,809,120 | | |
| 01620 | 2310000 | 3535 | *I RI* | *Pajisje Elektronike Identifikimi* **PEI** | 48,479,609 | | |
| 01620 | 2310000 | 3535 | *I RI* | *Sistem trametimi Live on-line aktivitete te KQZ (Hardware + Soft+Audio)* | 2,500,000 | | |
| 01620 | 2310000 | 3535 | *I RI* | *Pajisje IT a) Skaner profesional AD345 Avisio ose ekuivalent b)Smart Board c) laptop ekuivalent MacBook Air 15'* | 1,100,000 | | |
| 01621 | 2310000 | 3535 | *I RI* | *Pajisje (makineri ambalazhimi KutiVotimi ) Matrial Rulo Plastik* | 350,000 | | |
| 01620 | 2310000 | 3535 | *I RI* | *Dublikator per USB-te* | 250,000 | | |
| | | | | **Totali FINANCIM I BRENDSHEM 01** | **2,334,488,729** | **0** | **0** |
| | | | | **FINANCIM I HUAJ 02** | **11,900,000** | **11,900,000** | **11,900,000** |
| 01620 | 2310000 | 3535 | **23AC001** | *"Mbështetje për parlamentin dhe edukimin qytetar; mbështetje e KQZ-së" GRANT* | 11,900,000 | 11,900,000 | 11,900,000 |

**RELACION**
**Mbi**
**Dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2025**
**për**
**Komisionin Qendror të Zgjedhjeve**
**Faza STRATEGJIKE**

Hartimi i programit buxhetor afatmesëm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për periudhën 2025-2027, është në zbatim të Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.7, datë 28.02.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm", të Udhëzimit nr. 4, datë 28.02.2024 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027", si dhe të VKM nr.184, datë 27.03.2024 "Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027"
Në hartimin e programit buxhetor afatmesëm i jemi referuar kërkesave për shpenzime të politikave ekzistuese dhe politikave të reja me qëllim pwrmbushjen e misionit së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kërkesat buxhetore të KQZ-së, janë paraqitur sipas standardeve të miratuara, duke filluar me misionin, Formatet standarte të përgatitjes së kërkesave buxhetore PBA 2025-2027.

Misioni i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është të mbështesë zhvillimin e kulturës zgjedhore, të ofrojmë aksesueshmëri në mënyrë të barabartë në shërbime efektive e bashkëkohore për zgjedhësit dhe palët në proces, si dhe të zhvillojmë procese zgjedhore të sigurta në përputhje me standardet ndërkombëtare të besueshmërisë.
Veprimtaria e KQZ zhvillohet bazuar në parimet e pavarësisë, paanshmërisë, integritetit, transparencës, etikës profesionale, përfshirjes dhe barazisë gjinore.
KQZ ka përfshirë në mënyrë efektive buxhetimin e përgjigjshëm gjinor në dokumentat e PBA-së, në një program buxhetor "Planifikim, Menaxhim, Administrim", në të cilin është kryer integrimi gjinor dhe është aplikuar Buxhetimi i Përgjithshëm Gjinor në nivel Treguesi Kyç Performance dhe produkti.

Për periudhën 2025-2027, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përmes fondeve buxhetore të alokuara sipas tavaneve 2025-2027 do të përmbushë objektivat e synuara:
1. Përmirësimi i vazhdueshëm i kuadrit të përgjithshëm ligjor dhe i Kodit Zgjedhor, duke adresuar rekomandimet e bëra nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE)/ Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) në raportet e tyre të vëzhgimit të Zgjedhjeve.

2. Rritja e nivelit të informimit të qytetarëve për të drejtat e tyre lidhur me procesin zgjedhore, me qëllim rritjen e pjesëmarrjes në zgjedhje.

3. Rritja e transparencës në lidhje me fondet financiare të mbledhura nga partitë politike gjatë fushatave zgjedhore, përmes ndryshimeve të nevojshme ligjore.

Në zbatim të VKM nr.184, datë 27.03.2024 "Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027" janë miratuar tavanet për fazën strategjike të PBA 2025-2027, konkretisht për:

- **Shpenzime korrente**
- **Shpenzime kapitale me financim të brendshëm**
- **Shpenzime kapitale me financim të huaj**

Shpenzimet buxhetore për KQZ-në të detajuara sipas viteve të PBA-së dhe llojit të shpenzimeve, paraqiten në Formatin F2 dhe sipas tabelës së mëposhtme:

*Në mijë lekë*

| Vitet e PBA-së 25-27 | Shpenzimet korrente | Shpenzlme Kapltale | | Total Shenzime KQZ |
|---|---|---|---|---|
| | | Financim i Brendshem | Financim i Huaj | |
| **2025** | **268,707** | **1,500** | **11,900** | **282,107** |
| **2026** | **269,707** | **1,500** | **11,900** | **283,107** |
| **2027** | **270,707** | **1,500** | **11,900** | **284,107** |

**Sipas PBA 25-27 - Shpenzimet e KQZ-së sipas programeve dhe klasifikimit ekonomik detajohen për sa më poshtë:**

*Në mijë lekë*

| 2025 | Shpenzimet korrente | | Totali Shpenzimet korrente | Shpenzime Kapitale | | Totali Shpenzime Kapitale | Totali I shpenzimeve Buxhetore |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *Emertimi i Institucionit / Programit* | Shpenzime per paga dhe sig. shoqerore | Shpenzime te tjera korrente | | Financim i Brendshem 01 | Financim i huaj 02 | | |
| Komisioni Qendror i Zgjedhjeve | 600-601 | 602-606 | | 230-231 | 230-231 | | |
| Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 176,007 | 92,700 | 268,707 | 1,500 | | 1,500 | 270,207 |
| Zgjedhjet e pergjithshme dhe lokale | 0 | 0 | 0 | | 11,900 | 11,900 | 11,900 |
| | | | | | | *TOTAL TAVANI 2025* | *282,107* |

268,707

| 2026 | Shpenzimet korrente | | Totali Shpenzimet korrente | Shpenzime Kapitale | | Totali Shpenzime Kapitale | Totali I shpenzimeve Buxhetore |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *Emertimi i Institucionit / Programit* | Shpenzime per paga dhe sig. shoqerore | Shpenzime te tjera korrente | | Financim i Brendshem 01 | Financim i huaj 02 | | |
| Komisioni Qendror i Zgjedhjeve | 600-601 | 602-606 | | 230-231 | 230-231 | | |
| Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 176,007 | 93,700 | 269,707 | 1,500 | | 1,500 | 271,207 |
| Zgjedhjet e pergjithshme dhe lokale | 0 | 0 | 0 | | 11,900 | 11,900 | 11,900 |
| | | | | | | *TOTAL TAVANI 2026* | *283,107* |

| 2027 | Shpenzimet korrente | | Totali Shpenzimet korrente | Shpenzime Kapitale | | Totali Shpenzime Kapitale | Totali I shpenzimeve Buxhetore |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *Emertimi i Institucionit / Programit* | Shpenzime per paga dhe sig. shoqerore | Shpenzime te tjera korrente | | Financim i Brendshem 01 | Financim i huaj 02 | | |
| Komisioni Qendror i Zgjedhjeve | 600-601 | 602-606 | | 230-231 | 230-231 | | |
| Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | 176,007 | 94,700 | 270,707 | 1,500 | | 1,500 | 272,207 |
| Zgjedhjet e pergjithshme dhe lokale | 0 | 0 | 0 | | 11,900 | 11,900 | 11,900 |
| | | | | | | *TOTAL TAVANI 2027* | *284,107* |

## PROGRAMET BUXHETORE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), referuar fushave të përgjegjësisë, menaxhon fondet buxhetore sipas 2 programeve buxhetore:

1. **Planifikim Menaxhim Administrim**
2. **Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale**

## ANALIZA E PROGRAMEVE BUXHETORE

### *Politika Ekzistuese 2025-2027*

- **PROGRAMI "PLANIFIKIM MENAXHIM ADMINISTRIM"**

Programi "Planifikim, Menaxhim, Administrim" siguron mbështetjen juridike, financiare dhe me burime njerëzore me qëllim përdorimin e tyre me efektivitet për realizimin e objektivave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Tavanet buxhetore për programin "Planifikim, Menaxhim, Administrim", për vitet e PBA 2025-2027 janë detajuar si më poshtë:**

*Në mijë lekë*

| Shpenzimet për programin PMA 01610 sipas viteve 2024-2027 | Buxheti 2024 | PBA 2025 | PBA 2026 | PBA 2027 | Viti parë i PBA-së-2025 krahasuar me buxhetin e vitit 2024 në % |
|---|---|---|---|---|---|
| Shpenzime korrente | 261,207 | 268,707 | 269,707 | 270,707 | Rritur rreth 3 % |
| Shpenzime Kapitale me financim të brendshem | 15,000 | 1,500 | 1,500 | 1,500 | Pakesuar 90 % |
| Total programi 01610 | 276,207 | 270,207 | 271,207 | 272,207 | Pakesuar 2.2% |

- ***shpenzimet korrente të detajuara sipas tavaneve 2025-2027 paraqiten:***

*Në mijë lekë*

| Shpenzime për programin PMA 01610 | Buxheti 2024 | PBA 2025 | PBA 2026 | PBA 2027 |
|---|---|---|---|---|
| **TOTALI SHPENZIME KORRENTE** | **261,207** | **268,707** | **269,707** | **270,707** |
| *Paga* | 145,407 | 151,907 | 151,907 | 151,907 |
| *Kontribute dhe Sig. Shoqerore* | 23,100 | 24,100 | 24,100 | 24,100 |
| *Mallra dhe Sherbime* | 44,160 | 44,160 | 45,160 | 46,160 |
| *Transferta Korrente te Huaja* | 300 | 1,000 | 1,000 | 1,000 |
| *Transferta per Buxhetet Familiare e Individ* | 48,240 | 47,540 | 47,540 | 47,540 |
| **TOTALI SHPENZIME KAPITALE** | **15,000** | **1,500** | **1,500** | **1,500** |
| *Financim i Brendhsëm* | 15,000 | 1,500 | 1,500 | 1,500 |
| **TOTALI KQZ 01610** | **276,207** | **270,207** | **271,207** | **272,207** |

***Detajimi i politikave ekzistuese për këtë program paraqitet:***

1. **Shpenzime personeli Paga dhe sigurime shoqërore për vitin 2025janë miratuar në shumën 176.007 mijë lekë, sipas tavaneve** përfshin pagat dhe sigurimet shoqërore referuar nivelit të pagave të miratuara dhe organikës së miratuar prej 95 punonjës të aparatit të KQZ-së, për rritjen e performancës së administratës, në funksion të realizimit

të objektivave të institucionit, në zbatim të kërkesave ligjore, si dhe krijimin e kushteve optimale në këtë institucion.

**paga = 151.907.000 lekë**
**Sigurime shoqërore = 24.100.000 lekë**

2. ***Shpenzimet për mallra dhe shërbime për vitin 2025 janë miratuar në shumën 44.160.000 lekë.***
***Mallrat dhe shërbimet e*** parashikuara në këtë program ndihmojnë në mbarëvajtjen e punës së KQZ-së dhe të elementeve bazë të informimit dhe të komunikimit me partitë politike, organizatat dhe institucione të tjera të interesuara në forcimin e demokracisë nëpërmjet proceseve zgjedhore.
Referencat për çmimet jemi bazuar në kontratat ekzistuese.
Detajimi i tyre konsiston:
***Mallra në shumën 15,8 milion lekë***
    - Shpenzime operative
    - Karburant
    - Mallra për funksionim të pergjithshëm
    - Mallra për sesionet e edukimit
***Shërbime në shumën 28,3 milion lekë***
    - Shërbime të funksionimit të pergjithshëm
    - Shpenzime per mirembajtje e mjeteve te transportit
    - Shërbime të teknologjisë së informacionit
    - Sherbime per mirembajtje & siguri godine
    - Sherbime udhetime jashte vendit
    - Sherbime udhetime brenda vendit
3. ***Transferta korrente të huaja për vitin 2025 në shumën 1.000.000 lekë***, përfshin kuotën e anëtarësimit vjetor pranë AËEB - Shoqata Boterore e Trupave te Menaxhimit te Zgjedhjeve e cila është **1.000.000 lekë.**

4. ***Transferta për buxhetet familjare dhe individët për vitin 2025 në shumën 47.540.000 lekë*** është zëri i shpenzimeve nga i cili bëhet pagesa për shpërblimin e anëtarëve të Komisionit Rregullator, Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve. Llogaritja e fondeve është bërë në përputhje me parashikimin e nenit 12 të Kodit Zgjedhor të RSH.
5. ***Shpenzime kapitale me financim të brendshëm për vitin 2025 në shumën 1.500.000 lekë***
    - ***Paisje informatike dhe zyre në shumën 1.500.000 lekë***

Ka nevoja emergjente për plotësimin me Pajisje printimi dhe fotokopje të cilat janë mjaft të konsumuara dhe nuk plotësojnë kërkesat cilësore.

Në PBA 2025-2027, për zërin "Shpenzime kapitale me financim të brendshëm", vërejmë se fondet buxhetore të investimeve për KQZ-në krahasuar me vitin 2024 janë pakësuar në masën 90%.

## KËRKESA SHTESË MBI TAVAN 2025-2027 PËR POLITIKA EKZISTUESE - MALLRA E SHËRBIME 602- PJESË E POLITIKAVE TË REJA

*Kostoja për financimin e politikave ekzistuese të cilat i përmbahen prioriteteve të KQZ-së tejkalon tavanin indikativ të alokuar për programin "Planifikim Menaxhim Administrim", prandaj në këtë rast KQZ paraqitet me kërkesa shtesë mbi tavan si politika të reja në këtë program [sipas Formatit F3].*

KQZ duke analizuar dhe vlerësuar situatën dhe domodoshmërinë e shërbimeve specifike të institucionit me qëllim kryerjen dhe funksioneve të këtij instirucioni, në këtë fazë të PBA-së, evidenton kërkesa buxhetore për mallra dhe shërbime për vitin 2025 konkretisht:

**Shpenzime "Mallra dhe shërbime"**

- *Kërkuar nga KQZ në PBA 25-27 fondi prej 192.8 milion lekë;*
- *Tavani i miratuar në fazën e parë PBA 25-27 fondi prej 44.2 milion lekë;*
- ***Shtesa që kërkohet fondi prej 148.6 milion lekë;***
- *Shpjegimi për shtesën mbi tavan në këtë zë është:*
  a) ***67.1 milion lekë*** *"Shërbime të teknologjisë së informacionit"*, ku përfshihen mirëmbajtja vjetore e moduleve Softëare dhe Hardëare, blerje licencash, etj.
  Me mbështetjen e donatorëve të ndryshëm KQZ ka zhvilluar disa module të rëndësishme për për administrimin e procesit zgjedhor. Është detyrim dhe përgjegjësi e KQZ që tashmë këto module të mirëmbahen.
  Ndër to sjellim si ilustrim të sa më sipër Aktmarrëveshjen 4 vjeçare për projektet e digjitalizimit me Qeverinë Zvicerian e cila mbulonte vetëm ngritjen e sistemeve dhe nuk parashikohej shërbimi i mirëmbajtjes (detyrim 4 vjeçar) për nivelin e shërbimit (SLA) si dhe licencat.
  Shërbimi i mirëmbajtjes për këto module dhe shërbimi i mirëmbajtjes për Infrastrukturën TIK hardëare (kontribut in-kind i buxhetit të shtetit gjatë vitit 2023, në zbatim të kësaj Marrëveshje), si dhe në zbatim të Vendimit nr. 710, datë 21.8.2013 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit" (ndryshuar me VKM nr.755, datë 26.10.2016; nr. 287, datë 19.5.2021), përligj kërkesën tonë për fonde për shërbimet e mirëmbajtjes së moduleve dhe sistemeve të tjera IT për vitin 2025 e më tej.
  Mos funksionaliteti i sistemeve dhe moduleve (shërbime të teknologjisë së informacionit dhe Licencime sistemesh) mundet të krijojë problematika në vazhdimin e mbështetjes financiare të KQZ nga ana e donatorëve të ndryshëm, vecanërisht me partnerët e qeverisë Zvicerane.
  b) ***81.5 milion lekë*** Shërbime për mirembajtje & siguri godine shpenzime qeraje, për magazina për 10 mijë m2 dhe shpenzime të tjera të natyrës së sigurisë së objekteve.
    - ✓ **72 milion lekë** Shpenzime qiraje për magazina 8 mijë m2.
      Në bazë dhe për zbatim të VKM-së nr. 808 datë 12.12.2022 "Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit nga Ministria e Mbrojtjes tek Fondi Shqiptar i zhvillimit, të pronës me emërtim "Agjencia Lundër", me vendndodhje në Lundër Tiranë", 3,200 metra katror sipërfaqe magazinimi nuk do të jenë nën administrim dhe përdorim të KQZ-së. KQZ në vitin 2025 do ti duhen ambiente me sipërfaqe rreth 8,000 m2 për përpunimin dhe magazinimin e pajisjeve:

- Pajisjet e Votimit dhe Numërimit Elektronik – PEVN, PEI
- Kamerat e vëzhgimit të procesit në qendrat e votimit
- Materiale te tjera zgjedhore

✓ **9.5 milion lekë** Shërbime për mirëmbajtje & siguri godine
Në bazë të V.K.M nr. 808 date 12.12.2022 "Për ndryshimin e përgjegjësisë se administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Fond Shqiptar i Zhvillimit, te pronës me emërtim "Agjencia Lundër" me vendndodhje Lundër, Tiranë, Zona Kadastrale 2529 dhe për një ndryshim në V.K.M nr. 413, datë 11.07.2007 Për miratimin e listës se inventarit të pronave te paluajtshme shtetërore, te cilat i kalojnë ne përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes ( Drejtorisë se Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit" te ndryshuar, magazinat qe përdoren nga KQZ per administrimin dhe ruajtjen e materileve zgjedhore, pajisjeve te identifikimit elektronik si dhe kamerat e përdorura ne QV nuk janë me ne përdorim te KQZ. Per kete arsye duhet te parashikohen fonde per magazina te reja me sipërfaqe 10.000 metra katrore duke llogaritur sipërfaqen e magazinimit dhe te përpunimit te pajisjeve.

**Shpenzime "Kapitale me financim të brendshëm" Investime -01610**
**Për vitin e parë të PBA-se, 2025**

- *Kërkuar nga KQZ në PBA 25-27 fondi prej 85.4 milion lekë;*
- *Tavani i miratuar në fazën e parë PBA 25-27 fondi prej 1.5 milion lekë;*
- ***Shtesa që kërkohet fondi prej 83.9 milion lekë për vitin 2025;***
- *Shpjegimi për shtesën mbi tavan në këtë zë është:*
  a) 3 milion lekë Sistemi per indeksimin dhe kerkimin e pamjeve filmike
  b) 40 milion lekë Shtimi i kapaciteteve per ruajten e pamjeve filmike
  c) 34.6 milion lekë ERP-SOFTËARE për menaxhimin e proceseve, logjistikes, inventar etj
  d) 4.6 milion lekë Modul per menaxhimin e operatoreve [Menaxhimi i burimeve njerezore part time Moduli part time]
  e) 1.7 milion lekë Ankimet dhe denoncimet

**Për vitin e dyte të PBA-se, 2026**

- *Kërkuar nga KQZ në PBA 25-27 fondi prej 62.2 milion lekë;*
- *Tavani i miratuar në fazën e parë PBA 25-27 fondi prej 1.5 milion lekë;*
- ***Shtesa që kërkohet fondi prej 60.7 milion lekë për vitin 2026;***
- *Shpjegimi për shtesën mbi tavan në këtë zë është:*
  f) 11.2 milion lekë E archiva + arkivë financiare
  g) 19.5 milion lekë Hartat e Qv dhe facilitete te tjera
  h) 13.3 milion lekë E administrata
  i) 16.7 milion lekë Helpdesk/ helpline

**Në mënyrë të përmbledhur kërkesat për investime sipas viteve të PBA -së 2025-2027, si dhe kërkesat shtesë në këtë program janë si vijon:**

*Në lekë*

| Prog | Llogaria Ekonomike | Kod. D.Thesari | Kod Produkti | Emertimi I produktit | Buxheti 2025 | Buxheti 2026 | Buxheti 2027 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 01610 | 2310000 | 3535 | 18AC301 | Paisje informatike dhe zyre | 1,500,000 | **1,500,000** | 1,500,000 |
| | | | | Ekzistuese | 1,500,000 | **1,500,000** | 1,500,000 |
| 01610 | 2310000 | 3535 | *I RI FAZA I* | *Sistemi per indeksimin dhe kerkimin e pamjeve filmike* | 3,000,000 | | |
| 01610 | 2310000 | 3535 | *I RI FAZA I* | *Shtimi i kapaciteteve per ruajten e pamjeve filmike* | 40,000,000 | | |
| 01610 | 2310000 | 3535 | *I RI FAZA I* | *ERP - SOFTWARE per menaxhimin e proceseve, logjistikes, inventar etj* | 34,561,000 | | |
| 01610 | 2310000 | 3535 | *I RI FAZA I* | *Modul per menaxhimin e operatoreve [Menaxhimi i burimeve njerezore part time Moduli part time]* | 4,601,000 | | |
| 01610 | 2310000 | 3535 | *I RI FAZA I* | *Ankimet dhe denoncimet* | 1,707,720 | | |
| 01610 | 2310000 | 3535 | *I RI FAZA I* | *E archiva + arkivë financiare* | | 11,181,500 | |
| 01610 | 2310000 | 3535 | *I RI FAZA I* | *Hartat e Qv dhe facilitete te tjera* | | 19,495,400 | |
| 01610 | 2310000 | 3535 | *I RI FAZA I* | *E administrata* | | 13,321,500 | |
| 01610 | 2310000 | 3535 | *I RI FAZA I* | *Helpdesk/ helpline* | | 16,692,000 | |
| | | | | Te Reja | **83,869,720** | **60,690,400** | - |
| | | | | Totali | **85,369,720** | **62,190,400** | **1,500,000** |

***Për sa më sipër KQZ kërkon fonde shtesë, politika të reja për vitin 2025 në shumën 232.5 milion lekë, si vijon:***

- ***148.6 milion lekë Mallra dhe Shërbime***
- ***83.9 milion lekë Investime me financim të brendshëm***

- **PROGRAMI "ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME DHE LOKALE"**

**Tavanet në këtë program nga buxheti i shtetit [kap.01] janë në shumën 0- zero lekë.**

Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve në momentin e zgjedhjeve respektive të viteve të kaluara lokale apo të përgjithshme, ka ushtruar veprimtarinë për të siguruar funksionimin e zgjedhjeve të lira dhe efektive në vend.

Për këtë duke qenë se viti i parë i PBA-së 2025 është vit zgjedhor si dhe për të ***përmbushur detyrimet ligjore të Kodit zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, kërkojmë që në programin 01620 "Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale", të parashikohet tavan për shpenzime buxhetore në PBA 2025-2027, të cilat nga ana jonë janë paraqitur si politika të reja në këtë program, në formatin F3.***

Ekipet e Menaxhimit të Programeve në KQZ, në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit të Buxhetit kanë përgatitur buxhetin për programin "Zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore" bazuar në nevojat për shpenzime buxhetore, sipas parashikimeve në:

- ✓ Kodin Zgjedhor për; rekrutim personeli të përkohshëm, dhënie shpërblimi për personat të angazhuar në procesin zgjedhor, sigurim të infrastrukturës zgjedhore (bazë materiale dhe shërbime), etj
- ✓ vendimarrjen e deritanishme të Komisionit Regullator dhe Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për aspekte të procesit zgjedhor që shoqërohen me efekte financiare
- ✓ praktikat e krijuara nga organizimi dhe administrimi i zgjedhjeve të mëparshme

*Bazuar në sa më sipër,*

*kërkesa të cilat do të kërkohen si politika të reja mbi tavanet buxhetore të miratuara, janë si në tabelë:*

*ne leke*

| Shpenzimet për programin Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale 01620 | Buxheti 2025 | Buxheti 2026 | Buxheti 2027 |
|---|---|---|---|
| **Total Programi korrente +financim i brendshem** | **4,842,000,000** | **16,700,000** | **2,207,000,000** |
| **Shpenzime personeli [paga dhe sigurime]** | 407,000,000 | | 407,000,000 |
| **Shpenzime për Mallra dhe Shwrbime** | 2,100,000,000 | 16,700,000 | 1,800,000,000 |
| **Shpenzime Kapitale me Financim të brendshem** | 2,335,000,000 | | |

Në shpenzimet korrente, janë perfshirë pagat dhe sigurimet shoqërore për personelin e përkohshëm në funksion të realizimit të objektivave të institucionit, në zbatim të kërkesave ligjore, si dhe shpërblimi i komisionerëve të (ZAZ-ve, QV-ve, GNV-ve), audituesit e përgatitjes së listës së zgjedhësve dhe ndihmësat e tyre, trajnuesit e komisionerëve.

**Këto shpenzime të detajuara paraqiten si më poshtë sipas zërave të shpenzimeve:**

*ne leke*

| Shpenzimet për programin Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale 01620 | Buxheti 2025 | Buxheti 2026 | Buxheti 2027 |
|---|---|---|---|
| **Total korrente** | **2,507,000,000** | **0** | **2,207,000,000** |
| **Shpenzime personeli** | **407,000,000** | **0** | **407,000,000** |
| *Pagat personelit te perkohshem ne KQZ- 600* | 149,000,000 | | 149,000,000 |
| *Paga -Shperblimi i anetareve te KZAZ-ve, KQV-ve, GNV-ve, trajnuesve te KZAZ,KQV,GNV - 600* | 233,000,000 | | 233,000,000 |
| *601-Sigurime shoqerore dhe shendetesore per personelin e perkohshem* | 25,000,000 | | 25,000,000 |
| **Mallra dhe Sherbime** | **2,100,000,000** | | **1,800,000,000** |

**A. SHPENZIME PËR PAGA, Sigurime për personelin e përkohshëm dhe shpërblime për anetaret e komisioneve zgjedhore, trajnuesve te KZAZ,KQV,GNV**

**për vitin 2025 janë parashikuar 407 milion lekë nga të cilat:**

- paga dhe sigurime shoqërore e shendetësore për personelin e përkohshëm në shumën **174.000.000 lekë**
  - **paga = 149,000,000 lekë**
  - **Sigurime shoq. = 25,000,000 lekë**

**Për vitin 2025** në të cilin do të kryhen zgjedhjet e përgjithshme, për realizimin e gjithë procesit zgjedhor dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore brenda afateve të parashikuara, është e nevojshme punësimi i punonjësve me kohë jo të plotë pune, kategori e cila luan rol mbështetës

për zbatimin e të gjitha hallkave që nevojiten për kryerjen e detyrave konkrete për çdo pozicion pune.

- **shpërblimi i anëtarëve të KZAZ-ve, KQV-ve, GNV-ve, trajnuesve të KZAZ,KQV,GNV, në shumën 233,000,000 lekë**

Në këtë zë është parashikuar shpërblimi i: komisionerëve të (ZAZ-ve, QV-ve, GNV-ve), audituesit e përgatitjes së listës së zgjedhësve dhe ndihmësat e tyre, trajnuesit e komisionerëve,

a) **Shpërblimi i anëtarëve të KZAZ-ve, KQV-ve, GNV-ve në shumën 211.000.000 lekë.**

Janë parashikuar të shpërblehen 736 anëtarët e KZAZ-ve për periudhën nga momenti i emërimit deri në përfundim të shpalljes së rezultatit përfundimtar (92KZAZ*8), 38.500 anëtarët e KQV-ve për ditën e zgjedhjeve (5500QV*7), 3.600 anëtarët e GNV-ve për ditët e procesit të numërimit(900GN*4). Masa e shpërblimit të anetarëve të KZAZ-ve, është propozuar nga Drejtoria e Komisioneve dhe Materialeve Zgjedhore, bazuar në ngarkesën e punës dhe kohën e funksionimit të komisioneve. Propozimi konsiston në një masë shpërblimi sipas ngarkesës së secilës KZAZ si vijon:

- *KZAZ të cilat administrojnë deri në 50 QV-* Kryetari dhe zv/kryetari i KZAZ-së nga 65,000 lekë kurse sekretari dhe anëtarët KZAZ-së në masën 60,000 lekë.
- *KZAZ të cilat administrojnë deri në 80 QV-* Kryetari dhe zv/kryetari i KZAZ-së nga 100,000 lekë, sekretari 95,000 lekë kurse anëtarët KZAZ-së në masën 60,000 lekë.
- *KZAZ të cilat administrojnë mbi 80 QV-* Kryetari dhe zv/kryetari i KZAZ-së nga 120,000 lekë, sekretari 118,000 lekë kurse anëtarët KZAZ-së në masën 60,000 lekë.
- Kryetari i QV-së 4,000 lekë, anëtarët dhe sekretari i QV-së, përkatësisht nga 3,500 lekë;
- Ndërsa anëtarët e GNV-ve janë parashikuar të jenë me të njëjtën pagesë si në zgjedhjet pararendëse me 6,000 lekë.

Parashikimi për numrin është i njëjtë me parashikimin e vitit 2023, pasi pavarësisht ndryshimeve ligjore, nenit 46, pika 2 të Kodit Zgjedhor, deri tani nuk kemi një përllogaritje me sa mund të ndryshojë numri total i qendrave të votimit.

Auditet teknicienë: Në zbatim të nenit 61 të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja mbikëqyr procesin e hartimit të listave, duke i kërkuar informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe njësive të qeverisjes vendore për procesin e caktimit të zonave të qendrave të votimit dhe numrit të zgjedhësve për çdo qendër votimi, në përputhje me rregullat e këtij Kodi dhe Ligjit të Gjendjes Civile. Përvec dy auditëve teknicienë, për herë të parë, ligji parashikon që këta auditë teknicienë asistohen përkatësisht nga dy ndihmësa. Si auditët dhe ndihmësat e tyre emërohen nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Masa e shpërblimit të auditëve dhe ndihmës auditëve është, përkatësisht 239,000 lekë dhe 120,000 lekë për gjithë periudhën, nga momenti i emërimit deri në dorëzimin e raportit përfundimtar.

b) **Masa e shperblimit per trajnuesit në shumën rreth 22,000,000 lekë** Plani për trajnimin e komisioneve zgjedhore të niveleve të dyta dhe të treta, numri i trajnuesve, materialet si dhe gjithë logjistika në ndihmë të këtij procesi, është parashikuar nga Drejtoria e Komisioneve dhe Materialeve Zgjedhore.

Me qëllim rritjen e kapaciteteve trajnuese, rritjen e performances së administratës zgjedhore është parashikuar zhvillimi i trajnimeve cascade dhe me ekipe lëvizëse. Këto trajnime synojnë fillimisht rritjen e sensibilizimit të trupës pedagogjike në mbarë vendin për të shprehur interes duke vijuar më pas me zhvillimin e trajnimit për dy nivelet e trajnimit. Ne kerkesat buxhetore janë parashikuar kërkesa per

ambjente me qira, shpërblimin e trajnerëve në vitin 2025 si dhe ambjente me qira për trajnimet në nivel lokal (trajnerët ToT nëpër qarqe).

Nje risi e trajnimeve është parashikimi që trupa e trajnerëve do të konsolidojë të gjitha njohuritë si per trajnimin e administratës zgjedhore, ashtu edhe për monitoruesit e fushatës, si dhe trajnime të personelit teknik (operatorë) që do të trajnojë KQZ për implementimin e PEI , PEVN.

***Shpenzimet për mallra dhe shërbime* janë parashikuar në shumën 1.89 miliardë lekë për vitin 2025** dhe janë detajuar bazuar në kërkesat e institucionit për realizimin e gjithë procesit zgjedhor për vitin 2025 konkretisht sipas kategorive dhe viteve:

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**
**PBA 2025-2027 Faza Strategjike**
**Tabela Nr.2 Shpenzimet buxhetore 2025 - 2027 për programin "ZGJEDHJET E PERGJITHSHME DHE LOKALE"01620**

*ne leke*

| Nr. | PËRSHKRIMI | Kerkesat KQZ 2025-2027 | | | TAVANET PBA 25-27 | | | KERKESAT MBI TAVAN 25-27 | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2025 | 2026 | 2027 | 2025 | 2026 | 2027 | 2025 | 2026 | 2027 |
| | Mallra e Sherbime 602 | 1,890,000,000 | 16,645,176 | 1,626,647,437 | 0 | 0 | 0 | 1,890,000,000 | 16,645,176 | 1,626,647,437 |
| II | MALLRA | 478,994,739 | 14,350,176 | 414,891,975 | 0 | 0 | 0 | 478,994,739 | 14,350,176 | 414,891,975 |
| 1 | Materiale specifike ZGJEDHORE | 265,716,474 | 0 | 255,249,646 | | | | | | |
| | Kuti Materialeve zgjedhore | 22,680,000 | 0 | 0 | | | | | | |
| | Kode sigurie | 91,845,670 | 0 | 103,358,650 | | | | | | |
| | Fletë votimi, maska dhe letër | 103,819,484 | 0 | 104,544,276 | | | | | | |
| | Vula per komisionet | 20,970,000 | 0 | 20,970,000 | | | | | | |
| | Dhoma te fshehtesise dhe kuti kartoni per MZ | 17,041,320 | 0 | 17,016,720 | | | | | | |
| | Boje Timbruese | 9,360,000 | 0 | 9,360,000 | | | | | | |
| 2 | Shtypshkrime | 91,703,165 | 2,013,576 | 56,825,729 | | | | | | |
| | Proces verbale kimike dhe shenja dalluese | 68,612,016 | 1,512,576 | 34,704,516 | | | | | | |
| | Shenja Dalluese | 11,123,369 | 201,600 | 12,158,033 | | | | | | |
| | Udhezues | 5,532,480 | 257,400 | 3,949,680 | | | | | | |
| | Dokumentacion Zgjedhor | 183,600 | 0 | 183,600 | | | | | | |
| | Pyetsore | 1,935,000 | 42,000 | 1,798,800 | | | | | | |
| | Rregjistra | 474,600 | 0 | 474,600 | | | | | | |
| | Postera dhe Fletepalosje | 3,842,100 | 0 | 3,556,500 | | | | | | |
| 3 | Prodhim spote TV-radio | 19,800,000 | 10,000,000 | 9,800,000 | | | | | | |
| 4 | Materiale ndihmese për fushatën edukuese, | 19,367,100 | 1,581,000 | 16,952,100 | | | | | | |
| 5 | Materiale per kamerat ne QV | 61,447,500 | 0 | 54,887,500 | | | | | | |
| 6 | Kancelari | 19,000,000 | 0 | 19,000,000 | | | | | | |
| 7 | Karburant | 1,728,000 | 408,600 | 1,728,000 | | | | | | |
| 8 | Shpenzime per pritje e percjellje | 204,000 | 60,000 | 162,000 | | | | | | |
| 9 | Procesi i asgjesimit te fleteve te votimit (Materiale | 28,500 | 287,000 | 287,000 | | | | | | |
| III | SHERBIME | 1,411,005,260 | 2,295,000 | 1,211,755,462 | 0 | 0 | 0 | 1,411,005,260 | 2,295,000 | 1,211,755,462 |
| 1 | Sherbime te telefonise dhe internetit/transmetime, | 110,056,278 | 0 | 82,032,480 | | | | | | |
| 2 | Sherbime të teknologjisë së informacionit | 977,257,658 | 0 | 955,957,658 | | | | | | |
| 3 | Sherbime qeramarrje ambiente dhe automjete | 12,400,000 | 0 | 700,000 | | | | | | |
| 4 | Sherbime te ndryshme transporti | 47,701,600 | 1,795,000 | 47,701,600 | | | | | | |
| 5 | Sherbim udhetime brenda vendit | 22,299,500 | 455,000 | 19,503,500 | | | | | | |
| 6 | Sherbime per fushaten edukuese dhe sensibilizuese | 106,070,224 | 45,000 | 105,860,224 | | | | | | |
| 7 | Shperblimi i operatoreve për përdorimin e paisjeve të teknologjisë në QV [tab e shperblime 602] | 135,220,000 | 0 | - | | | | | | |

## B. SHPENZIME PËR MALLRA

### 1.Materiale specifike Zgjedhore

Në pasqyrën e buxhetit janë parashikuar materialet zgjedhore të cilat përgjithësisht sigurohen nga kompani të specializuara brenda dhe jashtë vendit, të cilat prodhojnë produkte zgjedhore.

Janë parashikuar të prodhohen:

***Kuti votimi dhe kuti për materiale zgjedhore***

Kutitë e votimit të cilat KQZ disponon dhe ka përdorur në çdo zgjedhje janë blerë që në vitin 2001, 2003. Këto kuti mbaheshin në magazinën e KQZ-së, Lundër, e cila gjatë vitit 2021 pësoi dëmtime të mëdha nga zjarri. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre kutive u dogjën tërësisht kurse pjesa tjetër u dëmtuan pjesërisht. Gjithashtu viti i hershëm i blerjes ka bërë që këto kuti të amortizohen të dëmtohen përgjatë viteve.

Bazuar në eksperiencën e zgjedhjeve të mëparshme, është menduar që të përdoret i njëjti sistem paketimi i materialeve zgjedhore, duke përdorur kuti amballazhi, si më poshtë:

***Kode sigurie***

Kodet e sigurisë sigurojnë që pajisjet dhe kompartimentet e tyre u sigurohet integriteti.

Memoriet USB jane te nevojshme per procesin e identifikimit sipas percaktimeve dhe akteve normative te komisionit rregullator per te mbajtur listen elektronike te zgjedhesve ne memorie, per shkak te përdorimit gjate proceseve zgjedhore te viteve 2021, 2022, 2023 nje pjese e tyre pas verifikimit kane shfaqur problematika teknike, e per shkak te rolit kritik qe kryejne performanca e USB-ve duhet te jete maksimale.

***Fletë votimi, maska dhe letër***

Në zbatim të nenit 97, të ligjit 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, për zgjedhjet për vendore, zgjedhësi voton me një fletë votimi për Kryetar në formatin A4 dhe një fletë votimi për Këshill në formatin A3 për të gjitha zonat zgjedhore. Sasia e fletëve të votimit është e barabartë me numrin e zgjedhësve, duke i shtuar 2%.

Kështu:

Në mungesë të informacionit për numrin e zgjedhësve, zakonisht përllogaritja është bërë bazuar në ekstraktin e dytë të dërguar nga gjendja civile, llogaritjet janë bërë mbi një numër të rrumbullakosur zgjedhësish: 3.700.000 zgjedhës

- Flete votimi për Deputet A4 Copë 3,774,000

Modeli dhe specifikimet e fletës së votimit nuk janë miratuar ende.

Llogaritjet për vlerën e fletës së votimit janë bërë bazuar në kontratën e zgjedhjeve të vitit 2019 dhe ofertën e marrë nga grupi i punës i ngritur për marrjen e treguesve ekonomikë.

- *Maskë për fletën e votimit për votuesit e verbër*

Në zbatim të nenit 108, pika 8 e Kodit Zgjedhor, KQZ ka detyrimin të pajisë komisionet e qendrave në të cilat ka votues të verbër me mjete të posaçme votimi në ndihmë të tyre. Kryetari i njësisë vendore njofton KQZ-në për numrin e zgjedhësve të verbër si dhe qendrat e tyre të votimit. Në mungesë të këtij informacioni nga ana e njësive vendore, është parashikuar një maskë për këtë qëllim për çdo qëndër votimi. Duke qenë se në këto zgjedhje votohet me dy fletë votimi, është llogaritur sasia prej 5500 maska në formatin A4 dhe 5500 maska në formatin A3 pra dy maska për çdo qendër votimi.

- *Letër termike për pajisjet e identifikimit elektronik dhe pajisjet e votim numërimit elektronik* e cila nevojitet për pajisjet elektronike te identifikimit dha tyre te votimit elektronik. Kjo letër ka specifika te ndryshme për çdo tip pajisje dhe në të printohet

- Identifikimin e çdo personi gjatë identifikimit elektronik
- Printimin e çdo vote gjatë votimit elektronik
- Raportet përfundimtare të votimit elektronik
- Raportet përfundimtare të identifikimit elektronik

***Vula per komisionet KZAZ-të dhe KQV-të***

Kodi Zgjedhor parashikon se qendrat e votimit përdorin dy vula ndersa ZAZ-ja përdor një vulë. Nëse do të marrim parasysh numrin e përafërt të KQV-ve 5.500, atëherë kemi:

5.500 (vula KQV) + 5.500 (vula për kryetarët e KQV-ve) + 100 (vula për KZAZ-të) + 550 (vula rezervë) = 11.650 vula gjithsej.

Vulat prodhohen nga Ministria e Brendshme.

***Dhoma te fshehtesise dhe kuti kartoni per MZ***

*Dhoma të fshehtësisë*

Për përllogaritjen e vlerës së dhomave të fshehta i jemi referuar eksperiencës së zgjedhjeve të mëparshme, duke konsideruar që do të përdoret e njëjta dhomë e fshehtë: me dy pjesë kryesore prej kartoni, pjesa mbështetëse me përmasa 105 cm lartësi, 54 cm x 40 cm përmasa suprinë, dhe

pjesa e fshehtësisë. Ndërsa për personat me aftësi të kufizuara do të perdoret një dhome shtesë e posaçme për persona me aftësi të kufizuara, me përmasa 80 cm lartësi dhe 60 cm x 50 cm suprinë, plus pjesën e fshehtësisë. Në total është parashikuar sasia 12000 copë dhoma fshehtësie normale (2 për cdo qendër votimi) si edhe 5500 copë dhoma fshehtësie për persona me aftësi të kufizuar.

***Kuti amballazhi për kutitë e votimit dhe materialeve zgjedhore;*** këtu përfshihen kutitë e votimit dhe kutitë e materialeve zgjedhore, të cilat dërgohen pranë komisioneve zgjedhore të ambalazhuara në kuti kartoni. Janë parashikuar të sigurohen 6.000 copë, bazuar në numrin e pritshëm të QV-ve.

*Kuti amballazhi për materialet e KZAZ-ve (zarfe+kodet e sigurisë);* këto kuti do të shërbejnë për paketimin e të gjitha llojeve të materialeve ju dërgohen KZAZ-ve, në total do blihen 500 copë.

*Kuti amballazhi për kancelaritë*; sasia e nevojshme për tu blerë 6.000 copë.

*Kuti amballazhi për materialet e trajnimit;* sasia e nevojshme 265 copë.

***Bojë timbruese***

Kodi Zgjedhor, i ndryshuar në nenin 99, pika 1, gërma "ë", përcakton se KQZ dërgon në KZAZ, jo më vonë se tre ditë nga data e zgjedhjeve, materialet zgjedhore, duke përfshirë dhe lëndë të posaçme për timbrimin e zgjedhësit. Gjithashtu, bazuar në procedurën e votimit që duhet të respektohet nga KQV, në zbatim të nenit 105, pika 1/ dh të Kodit Zgjedhor, zgjedhësi timbroset në dorën e majtë nga një anëtar i caktuar me vendim të KQV-së, me një lëndë të posaçme, të dukshme me shikim të lirë dhe që nuk hiqet për më pak se 24 orë, me qëllim shmangien e votimit më shumë se një herë dhe më pas i jepet fleta e votimit. Sasi e parashikuar është 12.000 copë, (2 copë për çdo qendër votimi plus një sasi rezervë).

**2.Shtypshkrime**

Në këtë zë të shpenzimeve përfshihen; tabelat e rezultateve, zarfa me logo të paraprintuar, etiketat adezive, shenjat dalluese, procesverbalet, librat e punës së komisioneve zgjedhore etj. Për pjesën më të madhe të tyre si për; tabelat e rezultateve , modelet e procesverbaleve, manualet e trajnimit, ose buletini, kërkohet vendimarrje e KQZ-së. Për pjesën tjetër të materialeve sië janë etiketat e kutive ose shenjat dalluese, KQZ ka tashmë një eksperiencë të mirë, këto materiale rishikohen dhe sasia e tyre përfshihet në buxhet. Në përgjithësi për të gjitha materialet, sidomos ato që përdoren nga KQV-të, sasia është llogaritur me nr. e QV-ve plus 10%.

**Prodhim spote promocionale, TV, Radio etj**

Edukimi, Informimi dhe ndërgjegjësimi i zgjedhësve përgjatë viteve 2024, 2025, 2026 synohet të realizohet përmes programeve të përgjithshme dhe programeve specifike, që shtrihet në kohë si në periudhë zgjedhore, gjithashtu dhe në periudhë zgjedhore.

Implementimi i programit të edukimit të zgjedhësve në tërësi si do të realizohet përmes aktiviteteve që synojnë ndërgjegjësimin e zgjedhësve, kryesisht të votuesve për herë të parë, pakicave kombëtare, personave me aftësi të kufizuar dhe target/grupeve të tjera. Përmes këtyre aktiviteteve vihet theksi tek rëndësia që ka vota dhe se të gjithë duhet të votojnë, si mënyra e vetme e vendimmarrjes. Shumë të rinj, nuk janë të informuar për institucionin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si funksionon, si organizohen zgjedhjet, kush, kur dhe cilat janë mjetet për të votuar. Nisur nga nevoja në rritje për më shumë ndërgjegjësim tek të rinjtë dhe pakicat kombëtare, në planin e punës për vitin 2025 janë parashikuar takime me grupe të veçanta, me qëllimin e vetëm ndërgjegjësimin për pjesëmarrje në zgjedhje, duke qenë se nevoja për

informim për procesin zgjedhor është gjithmonë një kërkesë në rritje, ndaj Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit ka përgatitur planet e punës.

**Kancelari**

KQZ përgjigjet për plotësimin e nevojave për materiale kancelarike nëpër ZAZ , QV dhe GNV. Sasia për materiale kancelarike është vendosur sipas kërkesës së bërë nga drejtoritë. Në plotësim të detyrimeve që përcakton Kodi Zgjedhor por edhe në zbatim të legjislacionit financiar, kërkesat janë krahasuar me shpenzimet reale të zgjedhjeve të mëparshme. Për çdo artikull është parashikuar një sasi rezervë prej 10%.

**Karburant**

Në këtë pasqyrë ështe parashikuar blerja karburantit te nevojshem, qe përdoret nga administrata e KQZ-së për përmbushjen e detyrave funksionale.

*Transporti i bazës materiale paraprake dhe përfundimtare.* Baza materiale zgjedhore shoqërohet nga punonjësit e KQZ, për shkak të rendësisë që ka. Këta punonjës dorëzojnë bazën materiale pranë KZAZ-ve dhe plotësojnë dokumentacionin përkatës. Transporti i tyre bëhet me mjetet e KQZ-së, por edhe me mjetet e tyre personale.

*Mbikëqyrja e procesit zgjedhor në përgjithësi*, konstituimit të KZAZ-ve, procesit të trajnimit të komisionerëve si edhe çdo problematikë tjetër e cila nuk mund të parashikohet në këtë moment, kërkon që të parashikohet një sasi karburanti për lëvizje të administratës së KQZ-së.

**Materiale elektrike për kamerat në QV**

Kodi Zgjedhor, në nenin 22, pika 2, përcakton se: KQZ-ja ka kompetencë të instalojë dhe përdorë video-monitorimi në qendrat e votimit. Në zgjedhjet për Kuvend të vitit 2021 u implementua për herë të parë shërbimi për video - monitorimin me kamera në qendrat e votimit ku u blenë 5214 copë kamera si dhe aksesorët përbërës të tyre.

Ky sistem u implemetua me sukses në zgjedhjet 2023 mirëpo disa prej kamerave rreth 10% e tyre (dhe pjesëve përbërëse) janë dëmtuar gjatë transportimit nga KQZ në QV dhe anasjelltas. Drejtoria e administrimit të të dhënave dhe sistemeve IT ka parashikuar blerjen e këtyre paisjeve te dëmtuara.

**Shpenzime pritje-përcjellje**

Për të mundësuar pritje të organizuar nga ana e KQZ për të gjithë delegacionet që do të vizitojnë vendin tonë me ftesë të KQZ-së, kemi parashikuar takime të profilit protokollar ku përfshihen:

- Pritje përcjellje e delegacioneve si dhe
- Dreka /darka të shtruara nga KQZ për delegacionet e institucioneve homologe

Lidhur me aktivitetet e përshkruara më sipër me institucionet vendase dhe të huaja, organizmave ndërkombëtarë do të jepen dhe dhurata simbolike nga ana e titullarit te institucionit.

**Procesi i asgjesimit te fleteve te votimit, Materiale pastrimi**

## C. <u>SHPENZIME PËR SHËRBIME</u>

Shërbimet e parashikuara jane shërbime te cilat jane te detyrueshme per organizimin dhe mbarëvajtjen e zgjedhjeve. Transmetimi i te dhënave, shërbimet e komunikimit dhe teknologji IT janë shërbime te cilat mundësojnë qe proceset te jete funksional duke siguruar integritetin, konfidencialitetin dhe disponueshmerine.

**Sherbime te telefonise dhe internetit/transmetime, publikime**

- *Shpenzime internet dhe telefoni për KZAZ-të* – parashikimi është bërë mbi bazën e kërkesës së Drejtorisë së administrimit të të dhënave dhe sistemeve IT "Shpenzime internet dhe telefoni për 92 KZAZ-të". Për parashikimin e kostos i jemi referuar eksperiencës së zgjedhjeve të mëparshme.
- *Shërbim për printimin e hartave (ZAZ, qarku, Shqipërisë)* – në zbatim të nenit 62, pika 10, të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, KQZ mbi bazën e informacionit të marrë nga kryetarët e njësive të qeverisjes vendore, krijon dhe përditëson hartën e zonave të qendrave të votimit, si dhe krijon bazën e të dhënave mbi vendndodhjet e qendrave të votimit. Kosto për këtë shërbim në zgjedhjet e vitit 2021 ka qenë përkatësisht 600.000 lekë.
- *Shërbim për monitorimin e fushatës zgjedhore* – me ndryshimet e ligjit "Për partitë politike" në vitin 2017, si edhe në zbatim të nenit 92/4, të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, KQZ jo më vonë se gjashtë muaj para datës së zgjedhjeve cakton një numër të mjaftueshëm personash të monitorojë fushatën elektorale.
- *Shërbim për auditimin e fondeve të fushatës* – fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike për qëllime të fushatës zgjedhore, auditohen nga auditues ligjorë, të cilët emërohen nga KQZ me short jo më vonë se 5 ditë nga shpallja e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve.

  Në përcaktimin e shumës së kontratës për secilin ekspert, për përcaktimin e orëve të punës mbahet parasysh kryesisht totali i shumave të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë për qëllime të fushatës zgjedhore.
- *Shërbime të tjera të paparashikuara* – për një sërë shërbimesh të tjera të kërkuara kryesisht nga Drejtorisë së administrimit të të dhënave dhe sistemeve IT, në pamundësi të përcaktimit të vlerës në këtë moment, është parashikuar një fond i caktuar në këtë projekt buxhet.

**Shërbime të teknologjisë së informacionit.**

Në zbatim të Kodit Zgjedhor mbi transparencën dhe administrimin sa më të mirë të procesit zgjedhor, KQZ disponon sistem të menaxhimit të informacionit të cilin e ka shfrytëzuar për të hedhur të dhënat në çdo process zgjedhor.
Sistemi aplikativ në strukturën e tij përbëhet nga module (varësisht në bazë të tipit të zgjedhjeve, vendore ose për kuvend) në të cilët hidhet informacioni i domosdoshëm dhe i nevojshëm mbi zonat, subjektet elektorale etj.
Më poshtë paraqiten modulet të cilat kanë nevojë për përditësim për të rritur performancën e administrimit zgjedhor:
*Shërbime dhe suport IT për PEI (Paisjet e Identifikimit Eletronik)*– në zgjedhjet për Kuvend të vitit 2021 si edhe në zgjedhjet për kryetar bashkie të vitit 2022, si dhe zgjedhjet vendore 2023 identifikimi i votuesve u krye nëpërmjet paisjeve të identifikimit elektronik në të gjitha qendrat e votimit ditën e zgjedhjeve.
Sistemi i ri i implementuar është sistem identifikimi elektronik me nënshkrim biometrik. Objektivi kryesor eshte funksionimi i saktë i Sistemit Elektronik të Identifikimit të Votuesve në Shqipëri
Për identifikimin e zgjedhësve do të perdoret Sistemi Elektronik i Identifikimit të Votuesve (SEIV) duke përdorur Pajisjet Elektronike të Identifikimit (PEI) të vendosura në çdo qendër votimi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas dispozitave te Kodit Zgjedhor dhe vendimeve te Komisionit Rregullator.

Pajisjet Elektronike të Identifikimit (PEI) do të sigurojnë identifikimin e saktë të zgjedhësve, bazuar në regjistrin elektronik të mbajtur në pajisje.

**Shpenzime për qeramarrje**

Për zhvillimin e trajnimit, ushtrimin e funksionit të KZAZ-ve, VNV-ve dhe QV, në raste të caktuara mund të përdoren ambjente private kundrejt pagesës. Në rastin e qendrave të votimit apo VNV-ve, ambjentet private mund të përdoren vetëm me vendim të KQZ-së.

